



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës L. NR. 03/L – 149 dhe në Rregulloren nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, **Gjykata Themelore Pejë** shpall këtë:

KONKURS NR.3/2018

1. Gjykata Themelore Pejë-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional- -----2
(dy) pozita
 2. Gjykata Themelore Pejë- Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave- ----
--1 (një) pozitë
-

Pozita nr.1

1. **KGJP001 - Zyra e Kryetarit të Gjykatës**

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional--
--2 (dy) pozita

Numri i referencës: RN00003003

Niveli i pagesës: 523.740

Koeficienti: 9 (nëntë)

Raporton tek: Kryetari i Gjykatës

Qëllimi i vendit të punës

1. Mbështetje profesionale për gjyqtaret dhe ndihmon në përgatitjen e memorandumeve, vendimeve të shkruara, aktgjykimeve, vendimeve të tjera, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike, duke bërë shqyrtimin e ligjeve, etj.

Detyrat Kryesore

1. 1. Prezanton në seanca gjyqësore të lëndëve civile, penale , konteste administrative dhe kundërvajtësi 20%
2. 2. Ndihmon në raste të tilla duke marrë shënime, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike, 20%
3. 3. Ndihmon në përgatitjen e vendimeve gjyqësore(Aktgjykime Vendime, Urdhëresa dhe shkresa tjera.) 20%

4. 4. Ndhomon në përgatitjen e memorandumeve të ndryshme.
10%
5. 5. Angazhohet në procedurat për zgjidhjen alternative të kontesteve gjyqësore
10%
6. 6. Bën hulumtime në shqyrtimin e ligjeve e praktikave gjyqësore të dobishme për gjykatën. 10%
7. 7. Bënë anonimizimin e vendimeve gjyqësore dhe
5%
8. 8. Kryen edhe punë tjera sipas nevojës
5%

Shkathtësitë

1.
 - Të ketë shkathtësi të dëshmuara ndër-personale
 - Komunikim të shkëlqyeshëm me shkrim dhe me gojë
 - Aftësi të kryej hulumtime gjyqësore
 - Njohuri në procedurat e Gjykatave

Edukimi

1.
 - Diplomë të fakultetit juridik

Kualifikimi

1.
 - Provimin e dhënë të jurisprudencës

Experienca

1. Tre (3) vite përvojë pune në lëmin juridike (Punë Profesionale me fakultet juridik).

Rethana te jashtzakonshme

1. Nuk paraqet ndonjë rrezik të jashtëzakonshëm

2. Pozita nr.2

2.KGJP001 - Zyra e Kryetarit të Gjykatës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave---1 (një) pozitë

Numri i referencës: RN00003004

Niveli i pagesës: 464.750

Koeficienti: 8 (tetë)

Raporton tek: Kryetari i Gjykatës

Qëllimi i vendit të punës

1. Këshillon dhe ndërmerr veprime lidhur me informimin mbi punën e Gjykatës si dhe monitoron mediat ne lidhje me raportimet ne gjyqësor. Për me tepër shërben edhe si pike kontaktuese për KGJK dhe gjykatat ne lidhje me informacionet ne web portal te gjyqësorit.

Detyrat Kryesore

1. 1. Në bashkëpunim me Kryetarin koordinon në tërësi të gjitha aktivitetet për informim dhe monitorim te mediave
20%
2. 2. Siguron qasje dhe transparence të punës së gjykatave, nëpërmjet ofrimit të informacioneve dhe dokumenteve për opinionin e gjerë publik dhe media përmes postimit te informatave ne portal te KGJK dhe gjykatave.

20%
3. 3. Në bashkëpunim me Kryetarin jepen informata të nevojshme lidhur me përgatitjen e takimeve me zyrtare dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore.
15%
4. 4. Nën mbikëqyrjen e Kryetarit shkruan komunikata për shtyp, si dhe përgatitë mbledhjet e shtypit, mediave si dhe intervistave, si dhe merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës respektivisht kolegjiunet e gjykatave .
10%
5. 5. Siguron shënime dhe informacione të nevojshme për udhëheqësin me te larte administrativ varësisht nga agjenda e takimeve.
10%
6. 6. Ndihmon ne përgatitjen e informatave për takimet e mbajtura me institucionet vendore e ndërkombëtare si dhe evidenton dhe mban të gjitha shënimet mbi

takimet e zhvilluara dhe i përgatitë raportet mbi rrjedhën e takimeve.
10%

7. 7. Në kuadër të fushë veprimtarisë së vet bashkëpunon edhe me zyrtarë tjerë dhe përgatitë raporte për punën e vetë.
10%
8. 8. Si dhe kryen çdo detyrë tjetër që i kërkohet nga Kryetari.
5 %

Shkathtësitë

1. 1.Shkathtësi të dëshmuara të menduarit strategjik, planifikimit dhe organizimit të punës -e nevojshme
2.Shkathtësi të shkëlqyera analitike dhe me shkrim -e nevojshme
3.Shkthësi për të prodhuar materiale kreative dhe profesionale në formate të ndryshme dhe në stil të qartë dhe konciz -E nevojshme

Edukimi

1. Diplomë universitarë- mardh enjë me publikun, gazetari, fakulteti juridik, filologjik apo filozofik.

Kualifikimi

1. Minimum dy (2) vite përvoja pune ne fushën përkatëse apo te ngjashme

Experienca

1. 1.Duhet të jetë i gatshëm të punojë në trusni dhe duhet të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti-E nevojshme
2.Duhet të jetë i gatshëm në raste të caktuara të punoj jashtë orarit -E nevojshme
3.Aftësi për caktimin e prioriteteve dhe për punë të pavarur administrative dhe programore-E nevojshme
4.Të jetë entuziast, transparent dhe të komunikoj mire me pale-E nevojshme
5.Njohja mire e gjuhës Shqipe, Serbe dhe Angleze -E dëshirueshme

Rethana te jashtzakonshme

1. Nuk paraqet ndonjë rrezik te jashtëzakonshëm.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Gjykata Themelore Pejë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me: Muhamet Asanaj, në tel: ose përmes postës elektronike (Muhamet .Asanaj@gjyqesori-rks.org) prej orës 8:00 -16:00. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dt.13.04.2018 gjer me 27.04.2018 dita e publikimit në gazetën ditore “ Zëri”.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit për pozitën nr.1. të i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin-diplomën e fakultetit Juridik, dëshmitë mbi përvojën e punës-të bashkëngjiten edhe kontributet e paguara për përvojë pune dhe dëshmitë për provimin e dhënë të Jurisprudencës dhe certifikatën që nuk jeni nën hetime dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune, për të cilin konkurroni.

Aplikacionit për pozitën nr.2. bashkëngjiten dëshmitë e diplomës së fakultetit Diplomë universitarë- mardh enjë me publikun, gazetari, fakulteti juridik, filologjik apo filozofik ,dëshmitë mbi përvojën e punës -bashkëngjiten edhe kontributet e paguara për përvojë pune, certifikatën që nuk jeni nën hetime dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune, për të cilin konkurroni

Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të listës së ngushtë për intervistë do të informohen me telefon, në afat ligjor.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

[Shkarko Aplikacionin](#)